



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 604/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga, Agon Ramadani Kryetar, Kimete Gashi Anëtare dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga (OE) Operatori Ekonomik "InterLab" sh.p.k, me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Funksionalizimi i QKMF-së dhe blerja e paisjeve mjekësore-faza e dytë" me nr. të prokurimit 624-22-8524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, më datën 27.01.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. Hudhet si e palejuar, ankesa e operatorit ekonomik, "InterLab" sh.p.k, me seli Prishtinë, nr. 604/22 (nr. protokolli), përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Funksionalizimi i QKMF-së dhe blerja e paisjeve mjekësore-faza e dytë" me nr. të prokurimit 624-22-8524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

II. Mbetet në fuqi, njoftimi iP Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës B58, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Funksionalizimi i QKMF-së dhe blerja e paisjeve mjekësore-faza e dytë" me nr. të prokurimit 624-22-8524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë

III. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Autoriteti Kontraktues- KK Suhareke me datën 28. 08. 2022, ka publikuar Njoftim për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Funksionalizimi i QKMF-së dhe blerja e paisjeve mjekësore-faza e dytë” me nr. të prokurimit 624-22-8524-1-2-1. Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë– furnizim.

AK ka publikuar njoftimin për dhënie duke rekomanduar për kontratë OE “Leta Med” me çmim me te lirë ne vlerë prej: 27.500,00 euro.

Me datë 12.10.2022, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të publikuar nga AK- Komuna e Suharekës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 31.10.2022, ka pranuar ankesë nga “InterLab” sh.p.k, me seli Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Funksionalizimi i QKMF-së dhe blerja e paisjeve mjekësore-faza e dytë” me nr. të prokurimit 624-22-8524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 604/2022.

Me rastin e vlerësimit paraprak, Paneli konstatoi se Ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (më tej: LPP), sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e këtij Organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar,

- ti lejohet AK- Komuna Suharekë, që të procedoj tutje me aktivitetin e prokurimit.

- *Seanca dëgjimore-*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

- *Konstatimet e Panelit Shqyrtues-*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se çështja kyçe si pikë përcaktuese që ka orientuar deri në vendimmarrjen si në dispozitiv të këtij vendimi qëndron tek çështja se OE ankues në këtë rast nuk ka dëshmuar apo argumentuar se klasifikohet si pale me interes në këtë aktivitet të prokurimit, për shkakun se në ankesën e tij nuk ka atakuar OE ofertues të renditur si i dyti me rradhë për nga çmimi, për faktin se OE ankues renditet në këtë rast i treti ndërsa në këtë aktivitet prokurimi oferta e “Bio-Lab shpk” është me çmim më të lire (29.300) se sa e OE ankues (36.000) si dhe në bazë të vendimit të AK-së oferta e “Bio-Lab shpk” është e pasuksesshme e jo OE i eliminuar si i papërgjegjshëm, lidhur me këtë, OE ankues në ankesën e paraqitur ka deklaruar si në vijim: *“Si pale me interes për këtë aktivitet të prokurimit referuar edhe letrës standarde të pasuksesshme dhe pasi kemi shikuar edhe dokumentacionin e OE të radhitur si i dyti shihet që nuk i plotëson kërkesat obligative të dosjes e tenderit por nuk i cekim për shkak se besojmë se gjatë rivlerësimit do shihet se edhe ky OE është i papërgjegjshëm dhe i radhës i përgjegjshëm jemi ne, andaj edhe paraqitet kërkesa për rishqyrtim dhe ankese në OSHP.”*, lidhur me këtë, PSH konstaton se OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar asnjë dëshmi, argument, arsye apo pretendim që oferta e “Bio-Lab shpk” të cilësohet si e papërgjegjshme, andaj PSH konstaton se OE ankues në këtë rast nuk ka dëshmuar që është pale me interes sipas nenit 4 të LPP-së, i cili saktëson se: *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit...”*, andaj duke u bazuar në se çka u tha si më sipër, PSH konstaton se nuk do të hidhet në trajtimin e pretendimeve ankimore të paraqitura si më lartë për faktin se OE ankues sipas PSH nuk ka ndjekur hapat procedural që parashihen me legjislacionin në fuqi andaj edhe u vendos sikurse në dispozitiv.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, *“Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”*. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së Komuna e Suharekes
- 1x1 OE "Interlab"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.